

UDHËZUES

Kursi i anglishtes për sektorin e turizmit dhe mikpritjes

Data e shpalljes: 14.06.2023.

Afati i fundit për aplikim: 30.06.2023.

Green Art Center – Prishtina në bashkëpunim me Komunen e Rahovecit ju fton të aplikoni për t'u bërë pjesë e kursit të gjuhës angleze për sektorin e turizmit dhe mikpritjes, i cili përmban 12 seanca të ndara në dy orë secila, dhe fillon duke nisur nga data 05 Qershor 2023.

Përmes këtij kursi, të rinjtë do të mësojnë si të përdorin anglishten në kontekstin e sektorit të turizmit dhe mikpritjes, duke përmirësuar të kuptuarin dhe aftësitë komunikuese me turistët e huaj. Kursi synon të ndihmojë të rinjtë të zgjerojnë mundësitë e tyre për punësim në këtë sektor dhe të kontribuojë në rritjen e sektorit të turizmit në vend.

Në përfundim të kursit të rinjtë do të pajisen me certifikatë pjesëmarrje.

Kursi është pa pagesë.

Kush mund të aplikojë?

Të gjithë të rinjtë e interesuar nga Komuna e Rahovecit që kanë një nivel baze të gjuhës angleze dhe dëshirojnë të mësojnë më shumë për industrinë e turizmit dhe mikpritjes.

Si mund të aplikohet?

Ju mund të aplikoni duke dërguar një kërkesë për pjesëmarrje në adresën e emaili info@greenartcenter.org

Në kërkesën tuaj, ju lutemi të përfshini emrin tuaj, moshën, numrin e telefonit, nivelin tuaj të anglishtes, dhe arsyen pse dëshironi të merrni pjesë në këtë kurs.

Afati i fundit për të aplikuar

Afati i fundit për dorëzimin e aplikimeve është **30 maj 2023**, ora 23:59. Të gjithë aplikantët e përzgjedhur do të njoftohen me telefon dhe email.

Kursi i gjuhës angleze zhvillohet në kuadër të projektit "ECOROUTES - Shtigje eko-turizmi në zonën ndërkuftare për promovimin e turizmit alternativ", i cili zbatohet nga Bashkia Kukës dhe Instituti i Kërkimeve Urbane në Shqipëri dhe nga Komuna e Rahovecit dhe Green Art Center - Prishtinë në Kosovë.

ECOROUTES bashkë-financohet nga Bashkimi Evropian dhe Fondet Kombëtare të vendeve pjesëmarrëse, në kuadër të Thirrjes së tretë për Projekt Propozime për Programin e Bashkëpunimit Ndërkufitar IPA Shqipëri – Kosovë 2020-2026.

Për më shumë informacion, mund të kontaktoni: info@greenartcenter.org